



**REPUBLIKA E KOSOVËS /**  
**REPUBLIKA KOSOVA / KOSOVA CUMHURIYETI**

---

**C.nr.1061/17**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN** – departamenti i përgjithshëm, trupi gjykues në përbërje prej gjyqtarit Arsim Hamzaj - kryetar dhe gjyqtarëve porotë Nerime Pasuli dhe Sejfulla Çesko - anëtar, në çështjen juridike të paditësit Sh. Ç. nga fshati ..., Komuna e Prizrenit, të cilin me autorizim e përfaqëson av.M. Ç. nga Prizreni, kundër të paditurës Gj. Ç. nga Vushtria, tani me adresë të panjohur, të cilën e përfaqëson përfaqësuesja e përkohshme av. L. S. nga Prizreni, për shkak të zgjidhjes së martesës, me datën **08.11.2018**, mori këtë:

## **A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET** në tërësi kërkesëpadia e paditësit Sh. Ç. nga fshati ..., Komuna e Prizrenit.

**II. ZGJIDHET me shkurorëzim martesë**, e lidhur në mes të paditësit - bashkëshortit Sh. Ç. nga fshati ..., Komuna e Prizrenit dhe të paditurës - bashkëshortës Gj. Ç. nga Vushtria, e lidhur me ..., pranë zyrës së gjendjes civile në Z.-Prizren, e regjistruar me numër rendor ...

**III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.**

### **A r s y e t i m**

Paditësi, Sh. Ç. nga fshati ..., Komuna e Prizrenit, të cilin me autorizim e përfaqëson av.M. Ç. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padinë kundër të paditurës Gj. Ç. nga Vushtria, tani me adresë të panjohur, për shkak të zgjidhjes së martesës. Në padi ka cekur se me të paditurën ka lidhur martesë me ..., pranë zyrës së gjendjes civile në Z., KK Prizren, me numër rendor ... Nga kjo martesë kanë një fëmijë të rritur G. Ç., e lindur më ... Raportet bashkëshortore gjatë gjithë kësaj periudhe kohore të jetës bashkëshortore gjithnjë kanë qenë të tensionuara, të shoqëruara me mosmarrëveshje serioze të cilat paditësi i ka duruar dhe toleruar për shkak të fëmijës dhe ruajtjes së familje. Pas lidhjes së martesë një kohë të bukur të gjatë propozuesit kanë jetuar mirë, mirëpo më vonë kanë filluar që të shfaqen mosmarrëveshjet, padurushmëri e jetesës së përbashkët dhe thellimi i papajtueshmërisë. Gjendja e këtillë ka zgjatur deri në atë kohë kur propozuesi para lufte ka

shkuar në Republikën e Kroacisë dhe është punësuar si furrtar në B., dhe shumë rrallë ka qenë në shtëpi, derisa vitet e fundit as nuk është lajmruar që ka ardhur në Kosovë . Në vitin 1999 janë ndarë faktikisht dhe vajza e mitur ka ngelur te i ati, duke e cekur se së bashku të dy palët kanë propozuar zgjidhjen e martesës në propozimin e datës 22.10.2003, dhe të njëjtit me autorizim e kanë autorizuar av.F. B., tani i ndjerë, shkak për të cilin gjykata e Qarkut në Prizren e ka hudhur poshtë propozimin për zgjidhje të martesës, sipas lëndës C.nr. 2/ 2000 të datës 25.03.2003. Në kohë të fundit paditësi ka krijuar familje me bashkëshorte tjetër, ka katër fëmij dhe jeton jashtë vendlindjes, në Republikën e Kroacisë. Duke e ditur që martesë e tij është e zgjidhur pas propozimit të përbashkët të të dy palëve dhe për të cilën i ka kryer të gjitha obligimet e tij. Për arsyet e lartcekura ka parashtruar padi, duke i propozuar gjykatës që pas administrimit të provave ta zgjidhë martesën në mes të këtu palëve ndërgjyqëse.

Pasi që e paditura është në adresë të panjohur gjykata nuk ka mbajtur seancë të pajtimit, konform nenit 76 par.1 pika 2 të Ligjit për Familjen i Kosovës (LFK).

Edhe gjatë shqyrtimit kryesor, i autorizuari e paditësit av. M. Q. nga Prizreni, ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se pas administrimit të provave materiale dhe konstatimit të gjendjes faktike janë plotësuar kushtet ligjore që gjykata të vendos meritorisht, dhe duke e cekur se këtu e paditura ka parashtruar propozim për zgjidhjen e martesës që nga viti 2000, prandaj edhe i ka propozuar gjykatës që të merr aktgjykim ku në tërësi të aprovohet kërkesëpadija e paditësit. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Meqenëse të paditurës nuk ka mundur t'i sigurohet adresa e saktë e vendbanimit, gjykata me propozimin e palës paditëse dhe konform dispozitave ligjore të nenit 79 par.3 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK) të njëjtës ia ka caktuar përfaqësuesin e përkohshëm nga radha e avokatëve.

Gjatë shqyrtimit kryesor përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurës av. L. S. nga Prizreni, e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësit në tërësi si të pa bazuar, duke theksuar se deri më tani nuk ka mundur të kontaktoj me të paditurën dhe për këtë arsye nuk ka dijeni lidhur me marrëdhëniet bashkëshortore në mes paditësit dhe të paditurës, duke propozuar refuzimin e kërkesëpadisë dhe të konsiderojë si të pa bazë.

Gjykata në këtë çështje juridike - kontestimore me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, sipas propozimit të palëve, ka zhvilluar procedurën dhe ka administruar këto prova: Çertifikatën e martesës me numër rendor ..., të lëshuar nga zyra e gjendjes civile në Prizren, datë ..., Aktvendimi e Gjykatës së Qarkut në Prizren C.nr 2/2000 te datës 25.03. 2003, Çertifikatën e lindjes për paditësin Sh. Ç., të lëshuar nga zyra e gjendjes civile në ..., datë ..., vërtetimin e lëshuar nga agjencia e punësimit të datës 05.03.2018, si dhe propozimin e parashtruar nga ana e palëve ndërgjyqëse së bashku me marrëveshjen për ruajtjen e fëmijëve të datës 22.10.2003.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartë cekura, në kuptimin e nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se:

Kërkesëpadia e paditësit duhet të aprovohet në tërësi si e **bazuar**.

Nga leximi i Çertifikatës së martesës me numër rendor ..., të lëshuar nga zyra e gjendjes civile në ..., datë ..., gjykata ka vërtetuar se paditësi me të paditurën kanë lidhur kurorë pranë zyrës së gjendjes civile në ..., më datë ..., e regjistruar me numër rendor ..

Nga leximi i Çertifikatave të lindjes për paditësin Sh. Ç., të lëshuar nga zyra e gjendjes civile në ..., datë ..., gjykata ka vërtetuar faktin e lindjes për të njëjtit ku ka konstatuar se është i lindur më .....

Nga Leximi i aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren, C.nr 2/2000 të datës 25.03.2003, Gjykata ka vërtetuar faktin se është konsideruar i tërhequr propozimi i përbashkët për zgjidhje të martesës me marrëveshje për shkak të mos përmbushjes së kushteve ligjore.

Nga Leximi në vërtetimin e lëshuar nga agjencia e punësimit te datës 05.03.2018, Gjykata ka vërtetuar se faktin se paditësi është i pa punësuar.

Nga Leximi në propozimin e parashtruar nga ana e palëve ndërgjyqëse së bashku me marrëveshjen për ruajtjen e fëmijëve të datës 22.10.2003, gjykata ka vërtetuar faktin se të dy bashkëshortet janë pajtuar se fëmija i tyre G. Ç. e lindur më .... të qëndroj me babain.

Sipas nenit 68 par. 1 të LFK-së është e paraparë se *“martesa mund të zgjidhet me shkurorëzim vetëm në bazë të vendimit të gjykatës”*. Me paragrafin 2 të këtij neni parashihet se *“njëri apo të dy bashkëshortët me marrëveshje të dyanshme mund të kërkojnë shkurorëzim duke parashtruar padi në gjykatën kompetente. Me nenin 69 të LFK-së, parashihet se “bashkëshorti mund të kërkojë shkurorëzim kur marrëdhëniet martesore janë çrregulluar seriozisht, ose në mënyrë të vazhdueshme, ose për shkaqe të tjera është zgjidhur në mënyrë të pakthyeshme”*. Ndërsa në par.2 të këtij neni ceket se *“Shkaqet e shkurorëzimit janë mesë tjerash: jeta e padurueshme e bashkëshortëve, shkelja e besnikërisë bashkëshortore, veprat penale kundër të jetës së bashkëshortit, keqtrajtimi serioz, lënia qëllimkeqe dhe e pa arsyeshme, sëmundja psikike e pa shërueshme dhe pa aftësia e vazhduar për të vepruar, ndërprerja e pa arsyeshme e jetës faktike për më shumë se një vit, si dhe shkurorëzimi me marrëveshje të dy anshme”*.

Në bazë të provave të administruara, gjykata gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për zgjidhjen e kësaj martese, andaj dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vlerësimi i gjykatës për bazueshmërinë e kërkesëpadi së për shkurorëzim bazohet në nenin 68 dhe 69 të Ligjit për Familjen të Kosovës, pasi që bashkësia martesore në mes të ndërgjyqësve nuk është e mundur, të cilën paditësi - bashkëshorti e ka manifestuar edhe me mosinteresimin që të rivendos bashkëjetesën martesore, si dhe duke u bazuar në faktin

se bashkëshortët pas lidhjes së martesës kanë jetuar bashkarisht një kohë, ndërsa tani jetojnë ndaras, që do të thotë se faktikisht e kanë ndërprerë bashkësinë martesore, pasi që paditësi - bashkëshorti jeton në Kroaci, ndërsa e paditura - bashkëshortja jeton në adresë të panjohur. Sipas vlerësimit të gjykatës për rivendosjen e marrëdhënieve bashkëshortore nuk ekzistojnë mundësitë reale, duke pasur parasysh periudhën për të cilën bashkëshortët nuk komunikojnë në mes veti (afër 15 vite) dhe nuk jetojnë bashkë dhe për këtë nuk është e arsyeshme që martesë vetëm formalisht të mbahet, pasi që e njëjta e ka humbur qëllimin dhe efektin e vet, për të cilën është lidhur. Gjithashtu gjykata ka konstatuar se martesë duhet të mbahet vetëm kur ekziston dashuria e ndërsjellë e bashkëshortëve, e cila shfaqet në një bashkëjetesë të harmonishme dhe për këtë nuk mjafton vetëm dëshira e njërit bashkëshort, pasi që kushti themelor për lidhjen e martesës është vullneti i palëve - bashkëshortëve, andaj dhe vendosi që ta zgjidhë martesën në mes të bashkëshortëve-palëve ndërgjyqëse.

Përfundimisht gjykata vlerëson se marrëdhëniet në mes të këtu bashkëshortëve janë ç'rregulluar në masë të tillë që nuk ka mundësi për ruajtjen e kësaj martesë, pasi që nuk ekziston harmonia bashkëshortore, e sidomos kushti thelbësor i lidhjes-ruajtjes së martesës - vullneti i palëve (bashkëshortëve), andaj dhe vendosi që ta zgjidhë martesën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Deklarimet e përfaqësuesit të përkohshëm të paditurës se nuk janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me nenin 69 par. 1 dhe 2 të Ligjit për Familje, gjykata i vlerësoi si të paqëndrueshme, nga arsyet e lartcekura, e sidomos për faktin se këtu palët ndërgjyqëse – bashkëshortët jetojnë të ndarë që një kohë të gjatë (rreth 15 vite) ku paditësi - bashkëshorti ka krijuar bashkësi të re jashtëmartesore, ndërsa e paditura - bashkëshortja jeton në adresë të panjohur.

Gjykata gjithashtu ka vlerësuar edhe provat dhe theksimet e tjera të palëve ndërgjyqëse, por ka gjetur se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është bazuar në dispozitat e nenit 452.4 të LPK-së dhe nenit 347 të LFK-së, pasi që asnjëra nga palët nuk i ka kërkuar ato.

Nga të lartë cekurat u vendos si më lartë, e konform nenit 143 të LPK-së, në lidhje me nenin 68 dhe 69 të LFK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**C.nr.1061/17, datës: 08.11.2018**

**Kryetari i trupit gjykues**  
**Arsim Hamzaj**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve, pas ditës së pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.